

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT

KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

DHE

ODA EKONOMIKE GJERMANO-KOSOVARE

DISKUTIM MBI LIBERAZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË

Prishtinë, 26 mars 2025, 10:00 – 12:30

Takimi u moderua nga Uran Haxha. Në takim morën pjesë 39 pjesëmarrës, duke përfshirë përfaqësues të bizneseve vendore dhe institucioneve publike në Kosovë.

Fjalët hyrëse

Greta Kazia, U.D Drejtore, OEGJK, në fjalën e saj hyrëse përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit që i janë bashkuar këtij diskutimi shumë të rëndësishëm për sektorin e energjisë. Vazhdoi tutje duke theksuar interesimin e kompanive gjermane për të investuar në tregun energjetik të Kosovës por dhe mbështetjen për liberalizimin e tregut, sepse kjo ndihmon në ngritjen e kapaciteteve vetëprodhuese të kompanive.

Ajo po ashtu falenderoi Sekretariatin e Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI) për mbështetjen e këtij diskutimi kaq të rëndësishëm për ekonominë e vendit.

Sekretariati i KKEI mbështetet nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) përmes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe ka ndihmuar me organizimin e këtij takimi me interesim të madh për ekonominë e vendit.

Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë

Ministria Rizvanolli përshëndeti të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë takim. Vazhdoi duke theksuar se liberalizimi i tregut duhet të vendoset në kontekstin e zhvillimeve të sektorit të energjisë.

Statistikat e viteve të fundit tregojnë disa trende pozitive. Në 10 vitet para krizës energjetike, çmimi i importit ka qenë mesatarisht 46 euro për MWh, ndërsa në tre vitet e fundit ka arritur 148 euro, që është 3.2 herë më i lartë. Pasiguria do të vazhdojë të rritet për shkak të situatës gjeopolitike. Ndër trendet pozitive, që nga heqja e bllok-tarifës në 2017, konsumi i energjisë është rritur, veçanërisht nga amvisëritë. Në vitin 2022 u vendos bllok-tarifa dhe u bë investim rekord në efikasitetin e energjisë, me mbi 35 milionë euro investime nga qeveria dhe Bashkimi Evropian. Si rezultat, konsumi i amvisërive është stabilizuar gjatë tre viteve të fundit - 2022-2024.

Kosova ka një Ligj për energjinë elektrike që ka hyrë në fuqi në vitin 2016 dhe është në përputhje me legjislacionin e BE-së. Si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, Kosova është e obliguar ta zbatojë këtë ligj. Ligji siguron të drejtën e shërbimit universal me çmime të rregulluara për të gjithë konsumatorët familjarë dhe për bizneset me më pak se 50 punëtorë ose me qarkullim vjetor nën 10 milionë euro.

Për ne është e rëndësishme për të theksuar se, sipas të dhënave të EUROSTAT, Kosova kishte energjinë më të lirë në rajon për një konsumator joshhtëpiak mesatar në vitin 2023, përfshirë dhe bizneset e mesme. Çmimi në 2023 ishte 137% më i lartë për bizneset në Maqedoninë e Veriut, 71% më i lartë në Serbi, dhe 59% më i lartë në Shqipëri.

Sipas legjislacionit aktual, nëse bizneset nuk mund të nënshkruajnë marrëveshje furnizimi me një nga 19 furnizuesit e licencuar, ato kanë të drejtë të furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit, KEK, për një periudhë 60-ditore.

Liberalizimi i tregut nuk do t'i vendosë kompanitë kosovare në disavantazh krahasuar me rajonin. Shqipëria ka nxjerrë në treg të gjithë konsumatorët me nivel të tensionit të lartë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut rreth 45% e konsumit të bizneseve sigurohet me çmime të rregulluara.

Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe inkurajoj që të ndahen sugjerimet për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme.

Uran Haxha, Moderator

Prezantoi panelin për diskutim: z. Ymer Fejzullahu (ZRRE), z. Agron Demi (Atlas Institute).

Pyetje për z. Fejzullahu: Cili do të jetë detyrimi i bizneseve pas liberalizimit të tregut?

Ymer Fejzullahu: Falënderoi të pranishmit dhe theksoi se ZRrE ka filluar procesin e liberalizimit të tregut që në vitin 2017, duke detyruar vetëm tre konsumatorë të mëdhenj (Sharrcem, Trepca dhe Ferronikeli) të kalonin në treg të hapur, ndërsa disa konsumatorë të vegjël gjithashtu kaluan në treg të hapur.

Në Mal të Zi, pothuajse të gjitha bizneset janë në treg të lirë, dhe Shqipëria gjithashtu ka detyruar bizneset të furnizohen me çmim të tregut. Në Maqedoninë e Veriut, bizneset me qarkullim deri në 30 mijë euro janë të detyruara të furnizohen me çmim të tregut.

Liberalizimi i tregut është planifikuar për vitin 2025, por afati është shtyrë deri më 1 qershor 2025 për të zhvilluar diskutime të mjaftueshme me bizneset dhe për të adresuar vështirësitë e fazës fillestare.

Gjatë krizës është funksionalizuar Bursa Shqiptare, që është bursa e parë në Evropë që implementon tregun IntraD dhe bashkimin e tregjeve, me mbështetje nga USAID dhe institucionet e Kosovës. Në vitin 2024, është bërë funksional tregu brenda ditor.

Uran Haxha, Moderator

Pyetje për z. Fejzullahu: A ka pasur vazhdim të diskutimit për këtë çështje vitin e kaluar nga ana e bizneseve që të thonë se i ka ardhë fundi kësaj shtyerje?

Përgjigje, Ymer Fejzullahu: Në të kaluarën e kemi pasë krizën energjetike por në të njëjtën kohë ka filluar mbështetja nga ana e Qeverisë përmes disa skemave që tashmë dihen.

Bizneset e kanë pasur mundësinë që të aplikojnë në fondet e BE-së edhe në ato të institucioneve të Kosovës që ta ulin faturën energjisë elektrike në këtë proces.

Bizneset kosovare dhe ato të Shqipërisë do ta kenë të njëjtin çmim të furnizimit me shumicë. Kurse tarifat e shfrytëzimit të rrjetit për KEDS dhe KOSST do të mbesin në fuqi. Aktualisht po flasim vetëm për rregullimin e 50 përqind të kostonë së furnizimit.

Çmimet e tregut në Kosovë janë më të ulëta në regjion, prandaj konsiderojeni këtë ndryshim si një mundësi të mirë dhe asesi si kosto shtesë. Po planifikojmë t'i bashkangjitemi tregut të Greqisë.

Uran Haxha, Moderator

Pyetje për z. Demi: Çfarë ndikimi mendoni se do të ketë tek bizneset? Do të ketë anën e saj po pozitive/negative?

Përgjigje, Agron Demi: Unë merrem me monitorimin e punës së ZRrE-së prej vitit 2011 dhe kemi kërkuar në vazhdimësi liberalizim të tregut, mirëpo koha është shumë e shkurtër për bizneset që të përgatiten. Është barrë e rëndë për bizneset që kanë më shumë se 50 punëtor dhe qarkullim më shumë se 10 milion euro.

Instituti ynë ka propozuar në këtë fazë largimin e TVSH-së prej 8 përqind prej faturës së energjisë, sepse këtë e aplikojnë edhe vendet e tjera.

Pajtohem me propozimin që prodhimi vendor, që është më i lirë, të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë konsumatorët, e pastaj importi të faturohet më shpenjtë për ata që konsumojnë më shumë energji elektrike.

Instituti ynë nuk pajtohet me një gjë: shteti mbledh 330 milion euro në emër të taksës mjedisore dhe vetëm 7 milion i kthen në mjedis. Nëse këto do ishin investuar në panele solare dhe programet e eficiencës së energjisë, konsumi i energjisë do të ulej dukshëm.

Artane Rizvanolli, Ministre, ME

Liberalizimi i tregut është ditë tash e disa vite dhe nuk ka mundësi që të shtyhet më tutje. Kriteret janë vendosur në vitin 2016. Muaji qershor është koha e duhur për të filluar zbatimin.

Pajtohem që të kemi sa më shume blloqe. 11 përqind të konsumatorëve familjar kanë shpenzuar 40 përqind të konsumit, po ashtu konsumi i bizneseve është në rritje.

Në vitin 2017 është hequr bllok-tarifa. Prej vitit 2017 kemi pasur këtë rritje të ngrohjes me energji elektrike. Kemi pasur edhe mungesë të investimeve.

Në KEK janë berë riparime të vogla. Blloku B-2 do të qëndroj larg operimit edhe pse e dhimbshme por ka qenë në plan tash e disa vite.

Investime në burimet e ripërtrishme janë bërë në shifra rekorde.

Pyetje: Në çfarë roli do të blejë rrymë në treg KEK-u? A ka pasur mundësi që të ndryshohen këto kriteret?

Përgjigje, Ymer Fejzullahu: Gjermania dhe Franca janë shtete të cilat i shkruajnë direktivat që shërbejnë si udhërrëfyes. Kërkojmë bashkëpunimin tuaj në këtë proces sepse koha për zbatimin e kësaj çështje ka qenë prej viti 2017 për çka është diskutuar edhe në Kuvend. E kemi zgjeruar skemën prej 100 kW, e kemi rritur në 200 kW, e që përfshin 90 përqind të konsumatorëve që janë të kyçyr në rrjet.

Në fazën fillestare pritet të ketë ngritje të çmimeve deri në 30 përqind të konsumatorët që do të dalin në treg të hapur. Deri në shtator pasojat mund të jenë zero, dhe pasojat e vetme mund të jenë në fillim të muajit nëntor apo dhjetor.

Kosova është e para që ka arritë targetin sipas skemës që ka përcaktuar Rregullatori prej 25 përqind në raport me BE-në.

Vërejtjen e vetme që e kemi pasë prej Sekretariatit është: ta bëjmë liberalizimin e tregut sa më shpejtë. Kemi angazhuar dhe ekspertë të jashtëm për këtë çështje, siç janë konsulentët e mbështetur nga USAID.

500 GW është konsumi i atyre që do të dalin në treg. Mund të lidhni kontratë vetëm me furnizuesin.

Pyetje, biznes privat:

Një përfaqësues nga sektori privat ngriti disa çështje shtesë lidhur me tregun e energjisë. Konkretisht, u theksua mungesa e marrëveshjeve të blerjes së energjisë (PPA) si mundësi për t'u lidhur drejtpërdrejt me bizneset që prodhojnë energji nga burimet e ripërtëritshme. Gjithashtu, u kërkua sqarim mbi aplikimin e taksës së karbonit dhe funksionimin e tregut të garancive të origjinës.

Pyetje, biznes privat:

A ndjekë ZRrE-ja politika lehtësuese për sistemet e licencimit të sistemeve solare?

Ymer Fejzullahu, ZRrE

Certifikatat e origjinës lëshohen për burimet e ripërtrishme nga ana e ZRrE-së. Janë të tregtueshme.

Sa i përket komunitetit të energjisë: mbështja nga USAID është ndërprerë dhe shpresojmë të gjejmë dike tejtër të na mbështes për këtë. Kryesore është liberalizimi i tregut.

Kriteret e përcaktuara me ligj duhet patjetër të zbatohen dhe ju ftojmë që së bashku ta kalojmë këtë proces.

Mbyllet diskutimi